

Pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Zyra e Komisionerit”) është depozituar kërkesa për informacion administruar me nr. 2279 Prot., datë 24.10.2024, si dhe regjistruar në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve me nr. rendor 24, datë 24.10.2024.

Zyra e Komisionerit publikon në raportet e saj vjetore në kapitullin “*E drejta për informim*” të dhënat mbi ankesat e depozituara gjatë vitit kalendarik si dhe mënyrën e përfundimit të tyre, të cilat janë:

- me vendim;
- informacioni/dokumentacioni i kërkuar i vënë në dispozicion ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ;
- jashtë objektit të ligjit (ankesa për çështje me natyrë individuale, ose trajtohen nga ligje të tjera specifike);
- jashtë afatit;
- të paplota;
- të kufizuara sipas nenit nr.17 të LDI;
- në proces shqyrtimi.

Raportet vjetore të Zyrës së Komisionerit i gjeni të publikuara në linkun në vijim <https://idp.al/raporte-vjetore/>

*VITI 2015*

[https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Raporti\\_Vjetor\\_2015.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Raporti_Vjetor_2015.pdf)

Duke filluar nga muaji janar deri në fund të vitit 2015, pranë Zyrës së Komisionerit janë depozituar 274 ankesa nga persona fizikë dhe persona juridikë lidhur me mosrespektimin dhe garantimin e së drejtës për informim, kryesisht me objekt “Refuzim dhënie informacioni dhe kopje të dokumentave zyrtare” ndaj autoriteteve publike.

Nga numri total i ankesave, janë dhënë 48 vendime për pranim të objektit të ankesës, urdhërim të autoriteteve për të dhënë informacionin e kërkuar dhe rrëzim të ankesës, si dhe janë zhvilluar 2 seanca dëgjimore.

Pas inspektimeve të kryera dhe dërgimit të kërkesave për parashtrim informacioni/dokumentacioni i kërkuar i është vënë në dispozicion ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ për 199 ankesa, ndërsa 5 ankesa kanë qenë të paplota, 3 ankesa janë depozituar jashtë afatit dhe 19 ankesa jashtë objektit të ligjit.

Të gjitha vendimet janë publikuar në faqen zyrtare, në linkun <https://idp.al/vendime-2015/>

#### VITI 2016

[https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Raporti\\_Vjetor\\_2016.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Raporti_Vjetor_2016.pdf)

Gjatë vitit 2016, u depozituan 684 ankesa, për 547 prej të cilave informacioni/ dokumentacioni i kërkuar i është vënë në dispozicion ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ, për 36 ankesa Komisioneri është shprehur me vendim, 65 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit, 7 ankesa kanë rezultuar jashtë afatit dhe 29 ankesa kanë rezultuar të paplota ndërsa 46 ankesa kanë vijuar të jenë në proces gjatë vitit pasardhës. Gjithashtu, janë dhënë 36 vendime për Autoritetet Publike, prej të cilave 2 vendime, që i përkasin 3 sanksioneve administrative ndaj personave përgjegjës për refuzim për vënie në dispozicion të informacionit publik të kërkuar.

Të gjitha vendimet janë publikuar në faqen zyrtare, në linkun <https://idp.al/vendime-2016/>

#### VITI 2017

[https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/RAPORTI\\_VJETOR\\_2017.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/RAPORTI_VJETOR_2017.pdf)

Gjatë vitit 2017, pranë Zyrës së Komisionerit u depozituan 560 ankesa, për prej të cilave 395 informacioni/ dokumentacioni i kërkuar i është vënë në dispozicion ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ. Për 66 nga këto ankesa, Komisioneri është shprehur me vendim. 77 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit. 8 ankesa kanë qenë jashtë afatit dhe 14 ankesa kanë rezultuar të paplota. Gjithashtu, janë dhënë 66 vendime për Autoritetet Publike, prej të cilave 57 vendime urdhërimi, 3 vendime rrëzimi, si dhe 6 vendime me sanksion gjobë.

Të gjitha vendimet janë publikuar në faqen zyrtare, në linkun <https://idp.al/vendime-2017/>

#### VITI 2018

[https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Raporti\\_Vjetor\\_2018\\_KDIMDP.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Raporti_Vjetor_2018_KDIMDP.pdf)

Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” gjatë vitit 2018, pranë Zyrës së Komisionerit u depozituan 820 ankesa, për prej të cilave 622 informacioni/ dokumentacioni i kërkuar i është vënë në dispozicion ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ. Për 37 nga këto ankesa, Komisioneri është shprehur me vendim, 116 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit, 9 ankesa kanë qenë jashtë afatit, 17 ankesa kanë rezultuar të paplota dhe 24 ankesa kanë vijuar gjatë vitit pasardhës. Gjithashtu, janë dhënë 37 vendime për autoritetet publike, prej të cilave 30 vendime urdhërimi, 3 vendime rrëzimi, si dhe 4 vendime me sanksion gjobë.

Të gjitha vendimet janë publikuar në faqen zyrtare, në linkun <https://idp.al/vendime-2018/>

#### VITI 2019

[https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Raporti\\_Vjetor\\_2019.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/Raporti_Vjetor_2019.pdf)

Gjatë vitit 2019, pranë Zyrës së Komisionerit u depozituan 786 ankesa. Nga numri total i ankesave, për 553 prej tyre informacioni/ dokumentacioni i kërkuar i është vënë në dispozicion ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ. Për 18 ankesa, Komisioneri është shprehur me vendim. Nga numri i përgjithshëm 34 ankesa rezultuan jashtë afatit, 16 të paplota, 140 jashtë objektit të ligjit, 21 u trajtuan sipas kufizimeve të nenit 17 të ligjit për të drejtën e informimit dhe 28 ankesa u mbartën në vitin 2020. Gjatë vitit 2019 janë shqyrtuar edhe 24 ankesat e mbartura nga viti 2018. Komisioneri doli me vendim për 18 ankesa, prej të cilave 11 urdhërim për dhënie informacioni, 2 rrëzimi dhe 5 vendime me sanksion administrativ.

Të gjitha vendimet janë publikuar në faqen zyrtare, në linkun <https://idp.al/vendime-2019/>

#### VITI 2020

[https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Raporti\\_IDP\\_2020.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/02/Raporti_IDP_2020.pdf)

Gjatë vitit 2020 u administruan 715 ankesa si dhe u vijua shqyrtimi i 28 ankesave të mbartura nga viti 2019. Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, për 472 prej tyre është vënë në dispozicion të ankuesit informacioni/dokumentacioni i kërkuar gjatë procesit të hetimit administrativ. Nga totali i ankesave të administruara, 24 rezultuan jashtë afatit, 13 ishin të paplota, 131 jashtë objektit, 23 u trajtuan sipas kufizimeve të nenit 17 të Ligjit për të drejtën e informimit, 1 ankesë është pezulluar dhe 44 u mbartën për shqyrtim në vitin 2021.

Për 35 ankesa Komisioneri është shprehur me Vendim, prej të cilëve 30 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 4 vendime rrëzimi dhe 1 vendim mospranimi.

Të gjitha vendimet janë publikuar në faqen zyrtare, në linkun <https://idp.al/vendime-2020/>

#### VITI 2021

<https://idp.al/wp-content/uploads/2024/01/RAPORTI-VJETOR-2021.pdf>

Zyra e Komisionerit, për vitin 2021, administroi 992 ankesa, si dhe vijoi me shqyrtimin e 44 ankesave të mbartura nga viti 2020 (në total 1036).

Nga totali prej 1036 ankesash, për 698 prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar është vënë në dispozicion të ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ. Ndërkaq, 158 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit, 33 jashtë afatit, 36 të paplota, 19 të

refuzuara bazuar në kufizimet e së drejtës për informim në përputhje me nenin 17 të ligjit dhe 2 ankesa janë pezulluar. Për 41 ankesa Komisioneri u shpreh me Vendim. 49 ankesa u mbartën për shqyrtim në vitin 2022.

Të gjitha vendimet janë publikuar në faqen zyrtare, në linkun <https://idp.al/vendime-2021/>

#### VITI 2022

<https://idp.al/ep-content/uploads/2024/01/Raporti-Vjetor-2022.pdf>

Në total, autoriteti administroi 1032 ankesa, si dhe vijoi me shqyrtimin administrativ të 49 procedurave të mbartura nga viti 2021 (gjithsej 1081 ankesa). Ndërkaq, 217 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit, për shkak se ishin me natyrë individuale, ose trajtohen nga ligje të tjera specifike. Gjithashtu, rezultojnë 21 ankesa të refuzuara, bazuar në kufizimet e LDI-së, 76 ankesa janë paraqitur jashtë afatit, 15 ishin të paplota, si dhe 48 të tjera janë mbartur për shqyrtim në vitin 2023.

Të gjitha vendimet janë publikuar në faqen zyrtare, në linkun <https://idp.al/vendime-2022/>

#### VITI 2023

[https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/Raporti\\_2023.pdf](https://idp.al/wp-content/uploads/2024/03/Raporti_2023.pdf)

Nga totali prej 1004 ankesash, për 609 prej tyre informacioni/dokumentacioni i kërkuar u është vënë në dispozicion ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ nga ana e Zyrës së Komisionerit. Gjithashtu, institucioni është shprehur me 45 vendime për 46 ankesa. Nga këto vendime, janë dhënë 41 vendime urdhërimi për dhënie informacioni, 3 vendime rrëzimi, dhe 1 vendim me sanksion administrativ. Ndërkaq, 146 ankesa kanë rezultuar jashtë objektit për shkak se ishin me natyrë individuale, ose trajtohen nga ligje të tjera specifike. Gjithashtu, rezultojnë 22 ankesa të refuzuara bazuar në kufizimet e ligjit, 59 ankesa janë paraqitur jashtë afatit, 36 ishin të paplota, si dhe 86 të tjera janë mbartur për shqyrtim në vitin 2024.

Të gjitha vendimet janë publikuar në faqen zyrtare, në linkun <https://idp.al/vendime-2023/>

#### VITI 2024

Gjatë periudhës 01 janar – 31 tetor 2024 janë administruar **806 ankesa** si dhe ka vijuar shqyrtimin për **86 ankesa** të mbartura nga viti 2023. Nga ankesat e paraqitura, për **540** prej tyre, informacioni/dokumentacioni i kërkuar është vendosur në dispozicion të ankuesve, gjatë zhvillimit të procesit të hetimit administrativ. Ndërkohë, **84** ankesa janë në proces shqyrtimi, **24** ankesa janë konsideruar të paplota, **66** ankesa janë jashtë afatit,

153 ankesa janë konsideruar jashtë objektit dhe 12 prej tyre janë refuzuar bazuar në kufizimet e nenit 17 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Janë zhvilluar 24 seanca dëgjimore dhe 26 inspektive dhe janë dhënë 13 vendime nga të cilat 5 vendime urdhërimi, 3 vendime me sanksion gjobe, 5 vendime rrëzimi, si dhe 1 vendim me gjobe për moszbatim të vendimit të Komisionerit, dalë në vitin 2023.

Të gjitha vendimet janë publikuar në faqen zyrtare, në linkun <https://idp.al/vendime-2024/>

Për sa mund të identifikojmë, autoritetet publike ndaj të cilëve është depozituar ankesë dhe që kanë përmbushur detyrimin duke e vendosur informacionin në dispozicion i gjeni në lidhjen nr. 1.

Faleminderit,

## Lidhja nr. 1

Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura Korce
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
Agjencia e Zhvillimit të Territorit
Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore
Agjencia Kombetare e Mjedisit
Agjencia Kombetare e Punesimit dhe Aftesive
Agjencia Kombetare e Pyjeve
Agjencia Kombetare e Shoqërisë së Informacionit
Agjencia Kombetare e Turizmit
Agjencia Kombetare e Ujesjelles Kanalizime
Agjencia Kombetare e Zonave të Mbrojtura

Agjencia Kombetare e Zonave te Mbrojtura, Dega Rajonale Korce
Agjencia Shteterore e Kadastres
Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
Autoriteti i Mediave Audiovizive
Autoriteti Kombetar i Ushqimit
Autoriteti Kombetar i Ushqimit, Dega Fier
Autoriteti Rrugor Shqiptar
Avokati i Popullit
Avokatura e Shtetit
Bashkia Berat
Bashkia Bulqize
Bashkia Cerrik
Bashkia Delvine
Bashkia Devoll
Bashkia Dimal
Bashkia Divjake
Bashkia Dropull
Bashkia Durres
Bashkia Elbasan
Bashkia Fier
Bashkia Finiq
Bashkia Fushe Arrez
Bashkia Gjirokaster
Bashkia Has
Bashkia Kamez
Bashkia Kavaje
Bashkia Kelcyre
Bashkia Kolonje
Bashkia Konispol
Bashkia Korce
Bashkia Kruje
Bashkia Kucove
Bashkia Kurbin
Bashkia Lezhe
Bashkia Librazhd
Bashkia Lushnje

Bashkia Malesi e Madhe
Bashkia Maliq
Bashkia Mallakaster
Bashkia Mat
Bashkia Memaliaj
Bashkia Miredite
Bashkia Patos
Bashkia Permet
Bashkia Pogradec
Bashkia Polican
Bashkia Prrenjas
Bashkia Puke
Bashkia Roskovec
Bashkia Rogozhine
Bashkia Sarande
Bashkia Selenice
Bashkia Shkoder
Bashkia Skrapar
Bashkia Tepelene
Bashkia Tirane
Bashkia Tropoje
Bashkia Vau Dejes
Bashkia Vlore
Dega e Doganes Shkoder
Departamenti Administrates Publike
Drejtoria e Pergjishme e Burgjeve
Drejtoria e Pergjithshme e Arsimit Parauniversitar
Drejtoria e Pergjithshme e Doganave
Drejtoria e Pergjithshme e Kopshtit Zoologjik
Drejtoria e Pergjithshme e Policise se Shtetit
Drejtoria e Pergjithshme e Sherbimeve te Transportit Rrugor
Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversal Korce
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durres
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durres
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier

Drejtoria Rajonale e Inspektoriatit Shteteror i Punes dhe Sherbimeve Shoqerore
Drejtoria Rajonale e Trashegimise Kulturore Shkoder
Drejtoria Vendore e Policise Diber
Drejtoria Vendore e Policise Kukës
Drejtoria Vendore e Policise Lezhe
Drejtoria Vendore e Policise Shkoder
Drejtoria Vendore e Policise Tirane
Eco Elb Sha
Fondi i Sigurimit te Detyrueshem te kujdesit shendetesor
Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Fondi Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor
Furnizimi i Sherbimit Universal FSHU sh.a.
Gjykata e Posacme kunder Korrupsionit dhe Krimin te Organizuar
Gjykata e Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Lezhe
Gjykata e Shkalles se Pare te Juridiksionit te Pergjithshem Tirane
Gjykata e Shkalles se Pare Tirane
Hekurudha Shqiptare Sh.a
IMT Bashkia Tirane
Inspektoriat i Mbrojtjes se Territorit Kruje
Inspektoriat Kombetar i Mbrojtjes se Territorit
Inspektoriat Kombetar i Trashegimise Kulturore
Inspektoriat Shteteror i Punes dhe Sherbimeve Shoqerore
Instituti i Shendetit Publik
Instituti i Statistikave
Instituti Kombetar i Regjistrimit te Trashegimise Kulturore
Instituti Kombetar i Trashegimise Kulturore
Keshilli Drejtues te RTSH
Keshilli i Qarkut Diber
Komisariati i Policise Mat
Kontrolli i Larte i Shtetit
Korporata Elektroenergjitike Shqiptare
Kryeministria
Kuvendi i Shqiperise
Ministria e Arsimit dhe Sportit
Ministria e Brendshme
Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural



Ministria e Drejtësisë
Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
Ministria e Financave
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Kulturës
Ministria e Mbrojtjes
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor
Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OSHEE Burrel
Prefektura e Kukës
Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të Kukës
Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkodër
Qendra e Botimeve Enciklopedike dhe Albanologjike
Qendra Spitalore Universitare Nënë Tereza QSUT
Radio Televizioni Shqiptar
Rezidenca Studentore Universitare nr 1 Tiranë
Rrjeti Akademik Shqiptar
Shërbimi i Proves
Shërbimi Social Shtetëror
Shkolla e Magjistratës
Shoqëria Albpetrol Sh.a
Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Lezhë sh.a.
Shoqëri Rajonale Ujësjetës Kanalizime Korçë
Shoqëri Rajonale Ujësjetës Kanalizime Lezhë
Shoqëri Rajonale Ujësjetës Kanalizime Pogradec
Shoqëri Rajonale Ujësjetës Kanalizime Sarandë
Spitali Rajonal Berat
Spitali Rajonal Dibër
Spitali Rajonal Elbasan
Spitali Rajonal Fier
Spitali Rajonal Gjirokastër
Spitali Rajonal Korçë
Spitali Rajonal Kukës
Spitali Rajonal Lezhë

Spitali Rajonal Shkoder
Spitali Rajonal Vlore
Spitali Universitar i Traumes
Struktura e Posacme kunder Korrupsionit dhe Krimet te Organizuar SPAK
Teatri Aleksander Moisiu
Teatri Bylis
Teatri Migjeni
Teatri Petro Marko
Ujesjelles Kanalizime Fier
Ujesjelles Kanalizime Shkoder
UK Lezhe SHA
Universiteti Aleksander Xhuvani Elbasan
Universiteti Bujqesor i Tiranes
Universiteti i Arteve
Universiteti i Mjekesise Tirane
Universiteti Ismail Qemali Vlore
Universiteti Luigj Gurakuqi Shkoder
Urdhri i Mjekut te Shqiperise
Urdhri i Psikologut
ZVA Tirane
Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare Fier
Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare Kukes

